



Duke u mbështetur në nenin 40 paragrafi 40.2 nën c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040 si dhe nenit 40 paragrafi 40.2 nën pikën 3) të Statutit të Komunës së Klinës me kërkesën e Drejtorisë së Financave, Ekonomi dhe Zhvillim të datës 15.03.2021, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e III-të të rregullt për vitin 2021, të mbajtur me datën 24.03.2021 mori këtë:

## V E N D I M

### Për transferim të mjeteve

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për transferim të mjeteve, në kategorinë ekonomike Shpenzime Kapitale fondi burimor 10.
2. Vendimi si në pikën 1 (një) behët nga Programi Shërbimet Publike Mbrojtja Civile (180) nënprogrami (18018), kodi funksional (0451) nga Projekti "Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza", kodi projekti 49617 të transferohet shuma prej 25,000.00€

Në Programin Planifikimi urban dhe mjedis (0620) shuma prej 25,000.00 në Projektin "Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Përqevë", kodi i projektit 48142.

3. Vendimi është i polotëfuqishem me miratim në Kuvendin e Komunës konform Rregullorës të QRK Nr.10/2019 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave.

Me këtë vendim njoftohet: MPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria e FEZH, Sherbimi për punë të Kuvendit dhe Arkivi i Komunës së Klinës.

### KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 06-10506 /21  
Klinë, me 31.03, /21

